

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Leter Printimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 102,714,900 (njëqind e dy milion e shtatëqind e katërbëdhjetë mijë e nëntëqind) Lekë, pa TVSH. vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a; ndarë në lote,

Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me vlerë 37,250,900 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) Lekë, pa TVSH.

Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **”Posta Shqiptare” sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, në vlerën 2,054,298 Lek (d milion e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë). ose*

Në Euro **19,415** (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) Euro.

Ndarë në lote:

Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”, me vlerë 745,018 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e tetëmbëdhjetë) Lekë, pa TVSH.

Në Euro **7,041.1** (shtatë mijë e dyzet e një pikë një) Euro.

Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 1,309,280 (një pesë milion e treqind e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH.

Në Euro **12,373,88** (dymbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e tetë) Euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- *operatorët ekonomikë duhet të jene të regjistruar në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë;*

Kjo pike plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 199% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më pak se 38 % e vlerës së fondit limit të lotit përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 38 % të vlerës së fondit limit të lotit përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kriteret teknike për Loti i I-rë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 10 (dhjetë) punonjës të siguruar në muaj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Nisur nga vlera relativisht e lartë e fondit limit, rëndësia për realizimin e kontratës, në kohë është gjykuar e nevojshme nga AK, që të sigurohet për qendrueshmërinë në numër dhe specialitete të operatorit ekonomik konkurues, të vërtetoje ky i fundit ekspertizen e tij profesionale duke paraqitur të pakten listpagesat e personelit të kërkuar më lart për 3 muajt e fundit si dhe numrin mesatar mujor i punonjësve që të jetë të pakten 10 (dhjetë) vetë, ku kjo organike personeli do ishte minimalja e mundshme për të përballuar realizimin e kësaj kontrate.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Certifikate ISO 9001:2015; (për sistemin e menaxhimit të cilësisë **për ofertuesin**); (ose ekuivalente).

Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor **për ofertuesin**); (ose ekuivalente).

Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **për ofertuesin**) (ose ekuivalente).

(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikate të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalent, ka të bëjë me menaxhimin mjedisor, i cili përfaqëson kalimin e drejtimit të kompanisë dhe respektimin e ligjeve, në një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit ka për çdo kompani një rol gjithmonë e më të rëndësishëm. Sistemi i menaxhimit mjedisor në këtë objekt është i domosdoshëm pasi ndotja e ajrit nga makinerite e printimit do të vinte në vështirësi dhe do të bëhej burim semundje / ndotje akustike.

Referuar objektit të prokurimit Njesia gjykon se është e nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuar nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të. Dhe duhet të aplikojnë disa standarte sigurie lidhur me mbrojtjen e mjedisit standarte të cilat garantojnë nga certifikimi i tyre nga organizma ndërkombëtare.

Certifikate ISO 45001:2018 ose ekuivalente specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH&S) dhe jep udhëzime për përdorimin e tij, për t'u mundësuar organizatave të ofrojnë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme duke parandaluar dëmtimet dhe shëndetin e lidhur me punën, si dhe duke përmirësuar në mënyrë proaktive performancën e tij OH&S.

ISO 45001:2018 është i zbatueshëm për çdo organizatë që dëshiron të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi OH&S për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në punë, për të eliminuar rreziqet dhe për të minimizuar rreziqet e OH&S (përfshirë mangësitë e sistemit), për të përfituar nga mundësitë e OH&S dhe për të adresuar menaxhimin e OH&S mospërputhjet e sistemit që lidhen me aktivitetet e tij.

ISO 45001:2018 ndihmon një organizatë për të arritur rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit OH&S. Në përputhje me politikën OH&S të organizatës, rezultatet e synuara të një sistemi menaxhimi të OH&S përfshijnë:

- a) përmirësim i vazhdueshëm i performancës së OH&S;
- b) plotësimin e kërkesave ligjore dhe kërkesave të tjera;
- c) arritjen e objektivave të SH&S.

ISO 45001:2018 është i zbatueshëm për çdo organizatë pavarësisht nga madhësia, lloji dhe aktivitetet e saj. Ai është i zbatueshëm për rreziqet e OH&S nën kontrollin e organizatës, duke marrë parasysh faktorë të tillë si konteksti në të cilin organizata vepron dhe nevojat dhe pritshmëritë e punonjësve të saj dhe palëve të tjera të interesuara.

ISO 45001:2018 nuk përcakton kritere specifike për performancën e OH&S, as nuk është urdhëruar për hartimin e një sistemi menaxhimi OH&S.

ISO 45001:2018 i mundëson një organizatë, nëpërmjet sistemit të saj të menaxhimit të OH&S, të integrojë aspekte të tjera të shëndetit dhe sigurisë, të tilla si mirëqenia/mirëqenia e punëtorëve.

ISO 45001:2018 nuk trajton çështje të tilla si siguria e produktit, dëmtimi i pronës ose ndikimet mjedisore, përtej rreziqeve për punëtorët dhe palët e tjera të interesuara.

ISO 45001:2018 mund të përdoret tërësisht ose pjesërisht për të përmirësuar sistematikisht menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Megjithatë, pretendimet e konformitetit me këtë dokument nuk janë të pranueshme nëse të gjitha kërkesat e tij nuk janë përfshirë në sistemin e menaxhimit të OH&S të një organizate dhe përmbushen pa përjashtim.

2.3.3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 (një) makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi **për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron**, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë apo mund tu vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshëm për realizimin me sukses të objektivit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të mallit nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3.**

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës. Operatorët Ekonomike duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (**një Kutë me pesë riza ku një rizëm me 500 fije Letër fotokopje A4.**

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim."

Argumentimi:

Paraqitja dorazi e mostra/modele për produktet Letër fotokopje A4, dhe Letër fotokopje A3, ka rëndësi në vlerësimin e ofertës teknike, kjo e ndërthurur edhe me skedën teknike që është e përfshirë në kriterin e mësipërm, dhe i shërben AK-së për të krijuar bindjen se produkti i ofruar është në përmbushje të plotë të specifikimeve teknike.

Theksojmë se mostrat e dorëzuara do të testohen edhe në pajisjen Hibrid mail, që ne përdorim për shërbime printimi pasi kjo makineri është një pajisje mjaft specifike dhe nëse cilësia e mostres/modelit të letres nuk është në standartet e kërkuara nuk realizon shërbimin e printimit.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteret teknike për **Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”**.

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë mesatarisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të siguruar në muaj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Nisur nga vlera relativisht e lartë e fondit limit, rëndësia për realizimin e kontratës, në kohë është gjykuar e nevojshme nga AK, që të sigurohet për qendrueshmërinë në numër dhe specialitete të operatorit ekonomik konkurses, të vërtetoje ky i fundit ekspertizen e tij profesionale duke paraqitur të pakten listpagesat e personelit të kërkuar më lart për 3 muajt e fundit si dhe numrin mesatar mujor i punonjësve që të jetë të pakten 15 vetë, ku kjo organikë personeli do ishte minimalja e mundshme për të përballuar realizimin e kësaj kontrate.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Certifikate ISO 9001:2015; (për sistemin e menaxhimit të cilësisë **për ofertuesin**); (ose ekuivalente).

Certifikate ISO 14001:2015, (për sistemin e menaxhimit mjedisor **për ofertuesin**); (ose ekuivalente).

Certifikate ISO 45001:2018 (për sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **për ofertuesin**) (ose ekuivalente).

(Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprahe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikate të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalent, ka të bëjë me manaxhimin mjedisor, i cili përfaqëson kalimin e drejtimit të kompanisë dhe respektimin e ligjeve, në një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit ka për çdo kompani një rol gjithmonë e më të rëndësishëm. Sistemi i menaxhimit mjedisor në këtë objekt është i domosdoshëm pasi ndotja e ajrit nga makinerite e printimit do të vinte në vështirësi dhe do të bëhej burim semundje / ndotje akustike.

Referuar objektit të prokurimit Njesia gjykon se është e nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuar nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të. Dhe duhet të aplikojnë disa standarte sigurie lidhur me mbrojtjen e mjedisit standarte të cilat garantojnë nga certifikimi i tyre nga organizma ndërkombëtare.

Certifikate ISO 45001:2018 ose ekuivalente specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH&S) dhe jep udhëzime për përdorimin e tij, për t'u mundësuar organizatave të ofrojnë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme duke parandaluar dëmtimet dhe shëndetin e lidhur me punën, si dhe duke përmirësuar në mënyrë proaktive performancën e tij OH&S.

ISO 45001:2018 është i zbatueshëm për çdo organizatë që dëshiron të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi OH&S për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në punë, për të eliminuar rreziqet dhe për të minimizuar rreziqet e OH&S (përfshirë mangësitë e sistemit), për të përfituar nga mundësitë e OH&S dhe për të adresuar menaxhimin e OH&S mospërputhjet e sistemit që lidhen me aktivitetet e tij.

ISO 45001:2018 ndihmon një organizatë për të arritur rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit OH&S. Në përputhje me politikën OH&S të organizatës, rezultatet e synuara të një sistemi menaxhimi të OH&S përfshijnë:

a) përmirësim i vazhdueshëm i performancës së OH&S;

b) plotësimin e kërkesave ligjore dhe kërkesave të tjera;

c) arritjen e objektivave të SH&S.

ISO 45001:2018 është i zbatueshëm për çdo organizatë pavarësisht nga madhësia, lloji dhe aktivitetet e saj. Ai është i zbatueshëm për rreziqet e OH&S nën kontrollin e organizatës, duke marrë parasysh faktorë të tillë si konteksti në të cilin organizata vepron dhe nevojat dhe pritshmëritë e punonjësve të saj dhe palëve të tjera të interesuara.

ISO 45001:2018 nuk përcakton kritere specifike për performancën e OH&S, as nuk është urdhërues për hartimin e një sistemi menaxhimi OH&S.

ISO 45001:2018 i mundëson një organizatë, nëpërmjet sistemit të saj të menaxhimit të OH&S, të integrojë aspekte të tjera të shëndetit dhe sigurisë, të tilla si mirëqenia/mirëqenia e punëtorëve.

ISO 45001:2018 nuk trajton çështje të tilla si siguria e produktit, dëmtimi i pronës ose ndikimet mjedisore, përtej rreziqeve për punëtorët dhe palët e tjera të interesuara.

ISO 45001:2018 mund të përdoret tërësisht ose pjesërisht për të përmirësuar sistematikisht menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Megjithatë, pretendimet e konformitetit me këtë dokument nuk janë të pranueshme nëse të gjitha kërkesat e tij nuk janë përfshirë në sistemin e menaxhimit të OH&S të një organizate dhe përmbushen pa përjashtim.

2.3.3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 1 (një) makinë tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi **për lotin përkatës/ shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkuron**, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës; për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë apo mund tu vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

2.3.4. Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës. Operatorët Ekonomike duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomike kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimin dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (**një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje)** dhe **një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**).

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim."

Argumentimi:

Paraqitja dorazi e mostra/modele për produktet (**një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje)** dhe **një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)**), ka rëndësi në vlerësimin e ofertës teknike, *për faktin se, biosja e letres është një proces mjaft i rëndësishëm në prodhimin e letres Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe Letër A4 "Traktor" (3 kopje)*, dhe i shërben AK-së për të krijuar bindjen se produkti i ofruar është në përmbushje të plotë të specifikimeve teknike.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për **“Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”**, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit të brendshëm Nr. 49, datë 01.09.2023**, të Administratorit të “Posta Shqiptare” sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdherin e administratorit nr. 55, datë 13.09.2023, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 **“Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”**, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike”** (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e

tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlllogaritur vlerën limit të kontratës.*

NJËSIA E PROKURIMIT